

VENDIM
Nr. 121, datë 17.2.2016

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË SISTEMIT TË
ARKIVIMIT DHE MENAXHIMIT TË DOKUMENTEVE TË VJETËRSISË NË PUNË
DHE TË PERIUDHAVE TË SIGURIMIT (DMAIS)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të arkivimit dhe menaxhimit të dokumenteve të vjetërsisë në punë dhe të periudhave të sigurimit (DMAIS).

2. DMAIS-ja administrohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

3. Përbërësit e arkitekturës, *software* dhe *hardware* të sistemit, miratohen nga Autoriteti Rregullator Koordinues.

4. Të dhënat që përmban sistemi ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore konsiderohen ato të dhëna të cilat grumbullohen nga vetë kjo bazë të dhënash, si:

- pozicioni i punës;
- afatet e qëndrimit në punë.

b) Të dhëna dytësore nuk ka, si të tilla konsiderohen të dhënat që merren nga baza të tjera të dhënash.

5. Dhënës i informacionit është Arkivi Qendror i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

6. Niveli i aksesimit në sistemin dhe bazën e të dhënave të DMAIS-së është, si më poshtë vijon:

a) Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka të drejta të plota administrative mbi bazën e të dhënave dhe sistemin në rolet e:

- i) administratorit;
- ii) raportuesit;
- iii) audituesit;
- iv) zhvilluesit.

b) Subjektet e tjera, sipas përcaktimit me vendim të Këshillit të Ministrave, mund të kenë akses në nivelin raportues apo statistikor, për të monitoruar apo për të raportuar.

7. Ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave shtetërore dhe proceset e punës në bazën e të dhënave të DMAIS-së përcaktohen me rregullore të brendshme ose me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në përputhje me rregullat në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”.

8. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe strukturat në varësi të tij për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama